



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 302, datë 18.06.2024

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E
POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.
247, DATË 02.05.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, PËR
KANDIDATIN Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR